



Samostalna Liberalna Stranka

Pasqyrat Financiare Vjetore dhe Raporti i Auditorëve të pavarur

01 Janar 2013 - 31 Dhjetor 2013



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur..	3
Pasqyra e Pozitës Financiare.....	7
Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve.....	8
Shënimet e pasqyrave financiare.....	9-10

Raport i Auditorëve te pavarur

Drejtuar Kryesisë së Samostalna Liberalna Stranka-SLS

Raport mbi Pasqyrat Financiare për qëllime specifike

Mohim i opinionit

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar raportet financiare të bashkëngjitura të Subjektit Politik Samostalna Liberalna Stranka-SLS (në vijim referuar si “Subjekti Politik” apo “SLS”), te përbëra nga Pasqyra e Pozitës Financiare me 31 Dhjetor 2013, Pasqyra e te Hyrave dhe Shpenzimeve për periudhën e përfunduar me këtë datë, dhe informacionin tjetër shpjegues të përfshira ne fq. 7-13.

Ne nuk shprehim një opinion mbi raportet financiare të subjektit Samostalna Liberalna Stranka-SLS. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin bazat për mohim të dhënies së opinionit, ne nuk kemi qenë në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit.

Bazat për mohim të Opinionit

- Siç është prezantuar ne pasqyrën e Pozitës financiare te bashkëngjitur, SP ka deklaruar gjendjen e parasë dhe ekuivalentëve te parasë ne vlerë 265,999.98 Euro me 31 Dhjetor 2013. Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që Subjekti Politik ka mbivlerësuar gjendjen e parasë për vlerën 192,522.81 Euro duke njohur gabimisht te hyrat gjatë vitit si gjendje e parasë me 31 Dhjetor 2013.
- Siç është prezantuar ne pasqyrën e Pozitës financiare te bashkëngjitur, SP ka deklaruar pasuri afatgjatë, Prona, Objekte dhe pajisje, ne vlerë 73,477.17 Euro me 31 Dhjetor 2013. Në mungese te dokumentacionit mbështetës ne e kishim te pamundur te konstatojmë nëse vlera e prezantuar e asetëve është e sakte.
- Siç është prezantuar ne pasqyrën e Pozitës financiare te bashkëngjitur, SP ka deklaruar pasuri vlerën e ekuitetit në shumën 339,477.15 Euro me 31 Dhjetor 2013. Në mungese te dokumentacionit mbështetës ne e kishim te pamundur te konstatojmë nëse vlera e prezantuar e ekuitetit është e sakte. Për më tepër SP ka mbivlerësuar suficitin e vitit vijues për 177,085.31 euro me 31 Dhjetor 2013.
- Siç paraqitet në Pasqyrën e te ardhurave dhe Shpenzimeve , SP SLS ka paraqitur te hyra te liruara nga te hyrat te shtyera ne shume prej 151,168.33 EUR për te cilat nuk ka asnjë dokument qe dëshmon se ka te hyra te tilla. Në mungese te dokumentacionit mbështetës ne e kishim te pamundur te

konstatohet nëse vlera e prezantuar e këtyre të hyrave është e sakte.

- Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që SP ka klasifikuar gabim shpenzimet e raportuara pasi ka mospërputhje në mes të shpenzimeve të deklaruara në shënimin 2 "Shpenzimet" dhe shpenzimeve të prezantuara në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.
- Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që subjekti politik nuk ka deklaruar dhe paguar tatimet dhe kontributet në paga ashtu siç kërkohet me legjislacionin tatimor në fuqi.
- Gjatë auditimit ton ne kemi konstatuar që SP SLS nuk ka prezantuar shënimet mbi pagesat mbi 5,000 Euro të kryera një marrësi të vetëm përkundër faktit që SP ka kryer pagesa të tilla.

Theksim i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen në lidhje me gjetjet e mëposhtme:

- Subjekti Politik nuk ka mirëmbajtur një kontabilitet të mirëfilltë për të mundësuar regjistrimin e transaksioneve financiare dhe përgatitjen e pasqyrave financiare sipas Standardeve të Kontabilitetit të aplikueshme në Kosovë.
- Subjekti Politik ka kryer pagesa një marrësi të vetëm në vlerë mbi 5,000 EUR brenda një dite në kundërshtim me kërkesat ligjore të Ligjit Nr:03/L-196 për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, neni 25, pika 2 e këtij ligji. Detyrimet shtesë të partive politike.
- Subjekti Politik nuk e ka të definuar me Statut, mundësinë e ushtrimit të kontrollit të brendshëm financiar të saj dhe të drejtën e anëtarëve për t'u informuar për të gjitha të hyrat dhe shpenzimet e subjekteve politike si dhe për përgjegjësinë e organit gjegjës për transaksione financiare, ashtu siç parashihet në ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 17 Kontrolli i Brendshëm.
- Subjekti Politik nuk ka respektuar kërkesat ligjore në lidhje me publikimin e raporteve financiare vjetore dhe të fushatës sipas ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar, paragrafi 5.1 dhe 5.2.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar

dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058 dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së subjektit politik për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpалosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Subjektin Politik ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.

- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.

- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të

mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit & Conto sh.p.k

Ymer Shatri
Auditor Ligjor
29 Nëntor 2017

Pasqyra e Pozitës Financiare

Pasuritë		Me 31 Dhjetor 2013	Me 31 Dhjetor 2012
Pasuritë afatgjata	Shënimi	Shuma në Euro	Shuma në Euro
Toka, objektet dhe pajisjet	2	73,477.17	0.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë tjera afatgjata			
Total pasuritë afatgjata		73,477.17	0.00
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme		0.00	0.00
Parapagimet			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3	265,999.98	151,168.33
Pasuritë tjera afatshkurtra			
Total pasuritë afatshkurtra		265,999.98	151,168.33
Total pasuritë		339,477.15	151,168.33
Ekuiteti			
Fondet e akumuluar		73,477.17	0.00
Suficiti / (deficiti) i vitit		265,999.98	128,324.03
Total Ekuiteti		339,477.15	128,324.03
Detyrimet			
Detyrimet afatgjata			
Huatë e pagueshme			
Të hyrat e shtyera		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatgjata			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme dhe të tjera		0.00	0.00
Detyrimet tjera afatshkurtra		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		0.00	0.00
Gjithsej detyrimet		0.00	0.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		339,477.15	128,324.03

Pasqyra e të hyrave dhe shpenzimeve

	Shënimi	Viti që përfundon me 31 Dhjetor	
		2013	2012
Të hyrat			
Të hyrat nga buxheti		265,999.98	0.00
Të hyrat nga anëtarësia		0.00	0.00
Donacionet dhe kontributet në të holla		0.00	0.00
Kontributet në natyrë në mall dhe shërbime		0.00	0.00
Të hyrat e fushatës		0.00	0.00
Te hyrat e liruara nga te hyrat e shtyera		151,168.33	0.00
Të hyrat tjera			
Gjithsej të hyrat për vitin		417,168.31	0.00
Shpenzimet			
Pagat dhe kompenzimet	4	67,703.28	44,075.57
Shpenzimet e transportit	4	7,140.00	5,573.06
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat	4	7,727.16	28,376.64
Shpenzimet e fushatës	4	105,814.94	0.00
Blerja e mallrave	4	59,549.34	11,948.55
Shpenzimet e përgjithshme	4	28,294.33	23,441.71
Shpenzimet e ndryshme	4	52,024.59	14,908.50
Gjithsej shpenzimet për vitin	4	328,253.64	128,324.03
Suficiti / (deficiti) për vitin		88,914.67	(128,324.03)

1. Informata te përgjithshme

Samostalna Liberalna Stranka është subjekt politik i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Udhëheqja: Slobodan Petrovic (kryetar)

Themelues: Slobodan Petrovic

Adresa: Gracanic

Pasqyrat financiare te Samostalna Liberalna Stran në Kosovë janë përgatitur sipas kërkesave te Ligjit Nr. 04/L-212 Për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L-174 Për financimin e subjekteve politike, të ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-058, neni 15 Raportimi Financiar.

Subjekti Politik mirëmban vetëm një llogari te vetme bankare ne bankën PCB.

Shënimi 2. Toka, objektet dhe pajisjet

	Bilanci në fillim të vitit (kosto historike)	Blerjet gjatë vitit	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi i vitit	Bilanci në fundë të vitit (vlera neto)
Toka			////		
Objektet					
Veturat					
Pajisjet e zyrës					
Pajisjet e teknologjisë informative					
Pajisjet tjera					
Gjithsej toka, objektet dhe pajisjet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

Shënimi 3. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	Me 31 Dhjetor 2013 Shuma në Euro	Me 31 Dhjetor 2012 Shuma në Euro
Paraja në bankë	0.00	0.00
Paraja në arkë	0.00	0.00
Gjithsej paraja dhe ekuivalentët e parasë	0.00	0.00

Shënimi 4: Shpenzimet

Shpenzimet	Shpenzimi në Euro	Pagesa në Euro	Borxhi i mbetur në Euro
Pagat dhe kompenzimet			
Pagat dhe kompenzimet, neto	67,703.28	67,703.28	0.00
Kontributet pensionale të punëmarrësit	315.12	315.12	0.00
Kontributet pensionale të punëdhënësit	961.36	961.36	0.00
Tatimet në të ardhura personale			
Beneficionet tjera			
Gjithsej	68,979.76	68,979.76	0.00
Shpenzimet e transportit			
Automjetet motorike të huazuara	7,140.00	7,140.00	0.00
Karburantet	23,329.80	23,329.80	0.00
Biletat, aeroplanit/autobusit/trenit/taksit etj.	1,068.00	1,068.00	0.00
Sigurimi dhe mirëmbajtja e veturave	294.00	294.00	0.00
Çdo shpenzim tjetër i transportit			0.00
Gjithsej shpenzimet e transportit	31,831.80	31,831.80	0.00
Reklamat, reprezentacioni dhe konferencat			
Lokali	350.00	350.00	0.00

Samostalna Liberalna Stranka

Shënime për Pasqyrat Financiare 01 Janar 2013 deri më 31 Dhjetor 2013

Ushqimi	22,366.79	22,366.79	0.00
Aktivitete kulturore dhe rekreative			0.00
Radio dhe spotet televizive	11,047.50	11,047.50	0.00
Stendat e afishmit dhe reklamimet në gazeta	60,222.00	60,222.00	0.00
Shpenzimet tjera të reklamave, reprezentacionit dhe konferencave	7,727.16	7,727.16	0.00
Gjithsej reklammat, reprezentacioni dhe konferencat	101,713.45	101,713.45	0.00
Shpenzimet e fushatës			
Shpenzimet e fushatës			0.00
Gjithsej shpenzimet e fushatës	0.00	0.00	0.00
Blerja e mallrave			
Furnizimi i zyrës	36,619.70	36,619.70	0.00
Pajisjet të vogla	22,929.64	22,929.64	0.00
Gjithsej blerja e mallrave	59,549.34	59,549.34	0.00
Shpenzimet e përgjithshme			
Qiraja e lokalit të zyrës	18,954.60	18,954.60	0.00
Telefoni, interneti dhe posta	5,459.64	5,459.64	0.00
Rryma, shërbimet komunale (uji dhe mbeturinat)	2,309.61	2,309.61	0.00
Shpenzimet e zhvlerësimit të pasurisë afatgjatë	0.00		

Shpenzimet lidhur me donacionet dhe kontributet ne natyrë në mallra dhe shërbime	0.00	0.00	
Gjithsej shpenzimet e përgjithshme	26,723.85	26,723.85	0.00
Shpenzimet e ndryshme			
Mirëmbajtja e pajisjeve dhe hapësirave të zyrës	5,260.00	5,260.00	0.00
Shpenzimet që nuk janë përfshirë në asnjë kategori tjetër	34,545.44	34,545.44	0.00
Gjithsej shpenzimet e ndryshme	39,805.44	39,805.44	0.00
Gjithsej shpenzimet	328,603.64	328,603.64	0.00